

UNË, TI,



TË GJITHË
TË MBROJTUR



Save the Children

Save the Children lufton për të drejtat e fëmijëve.

Ne bëjmë të mundur përmirësimin e shpejtë dhe afatgjatë të jetës së fëmijëve në mbarë botën

Save the Children lufton për:

- një botë e cila respekton dhe çmon çdo fëmijë
- një botë që dëgjon nga fëmijët dhe mëson
- një botë në të cilën fëmijët gjejnë shpresa dhe kanë shanse

ISBN 13: 978-91-7321-227-4

ISBN 10: 91-7321-227-X

Code no: 3360

© 2006 Save the Children

Udhëheqës Projekti: Lena Karlsson
Shkruar nga: Ravi Karkara, Fahmida Shoma Jabeen, Neha Bhandari
Kontribues: Alana Kapell, Clare Feinstein, Elkane Mooh, Elizabeth Jareg,
Rasa Sekulovic, Sofia Hildebrand dhe Turid Heiberg
Menaxhim prodhimi: Neha Bhandari
Kopje dhe publikim: Liz Kwast and Ragnee Bath
Ilustrimet: Sanjay Madnani
Vizatimi dhe shtypshkrimi: Format Printing Press, Nepal
Botuar nga : Save the Children Sweden

Ky botim financohet nga Oak Foundation, SIDA dhe Qeveria Norvegjeze.

Save the Children Sweden

SE-107 88 Stockholm

Tel: +46-8-698 90 00

Fax: +46-8-698 90 10

info@rb.se

www.rb.se



DHUNA NUK ËSHTË E DREJTË!

Kontribut i
Save the Children
në Studimin e Sekretarit
të Përgjithshëm të OKB-së
mbi Dhunën ndaj Fëmijëve

KY LIBËR ËSHTË I

Emri:

Skolla:

Klasa/Viti:

DY FJALË RRETH MEJE...


Ngjyra që më pëlqen më shumë

Kafsha që dua më shumë

Ushqimi që ha më me qejf


Muzika që më pëlqen më shumë

Çfarë më pëlqen të bëj





Mesazh nga Sekretari i Përgjithshëm i Save the Children të Suedisë



Për Save the Children, është shumë e rëndësishme që të gjithë fëmijët e mbarë botës të jenë të mbrojtur dhe të mund të bëjnë një jetë pa lëndime dhe pa dhunë. Për këtë arsye Save the Children ka qenë një partner i rëndësishëm në Studimin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve (të cilin këtej e tutje do ta përmendim me fjalën Studimi.)

Studimi ka parë se si fëmijët dhe të rinjtë përballen me dhunën në mbarë botën dhe se çfarë mund të bëhet për ta ndaluar atë. Duke vazhduar leximin ju do të mësoni më shumë për atë çka thuhet në Studim.

Një falënderim i veçantë i drejtohet Prof. Paulo Pinheiro dhe Sekretariatit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Studimin mbi Dhunën ndaj Fëmijëve dhe për punën që ata po bëjnë për t' i dhënë fund asaj.

Të shuntë janë ata në Save the Children në mbarë botën, që kanë punuar shumë për ta ndaluar dhunën ndaj fëmijëve. Unë do të falënderoja veçanërisht Grupin e Global Task të Save the Children kundër Dhunës ndaj Fëmijëve dhe Qendrat Kombëtare dhe ato



Rajonale të Save the Children në të gjithë botën.


Save the Children beson se fëmijët dhe të rinjtë dinë më shumë për vetveten. Prandaj është e rëndësishme të pyeten ata se si ndihen dhe se çfarë mendojnë. Ja përse për këtë Studim ne bashkëpunojmë me fëmijët dhe të rinjtë nga e gjithë bota. Për këtë ne duam t' i falënderojmë të gjithë ata.

Save the Children beson gjithashtu se fëmijët dhe të rinjtë mund të ndihmojnë për të ruajtur veten dhe të tjerët. Kjo bëhet e mundur kur ata kanë njohuri të mjaftueshme rreth dhunës. Prandaj dhe ne e kemi shkruar këtë libër, veçanërisht për ata të moshës 7 – 12 vjeç. Por edhe të tjerë mund ta lexojnë atë. Ne shpresojmë me gjithë mend se ky libër do të jetë i dobishëm për ju. Duke e lexuar ju do të mësoni mjaft gjëra rreth dhunës dhe se çfarë mund të bëni për të mbrojtur veten dhe fëmijët e tjerë.



Prandaj, lexojeni atë dhe ruajeni veten!

Sharlote Petri Gornicka
Sekretare e Përgjithshme
Save the Children Suedi



Falënderit o Miq!

Unë dua të falënderoj të gjithë ata miq që na ndihmuan për të mbaruar këtë libër. Një falënderim me gjithë zemër Ravi Karkara, Fahmida Shoma Jabeen dhe Neha Bhandari që e shkruan këtë libër. Një falënderim për Alana Kapell, Kler Feinstein, Elkane Moch, Liz Kuast, Elizabeta Jareg, Rasa Sekuloviç, Sofia Hildebrand dhe Turid Heiberg, të cilët na ndihmuan ta bëjmë më mirë këtë libër.

Një falënderim për Fondacionin Oak, SIDA (Agjencia Suedeze për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar) dhe Qeverinë Norvegjeze që na dha paratë për ta bërë këtë libër. Falënderojmë ekipin e Tulir, një grup që punon në Indi për të mbrojtur fëmijët kundër abuzimit seksual, i cili na ndihmoi me kapitullin 'Gjërat që mund të bëni për të ruajtur veten.'

Një falënderim i veçantë për Sanxhaj Madhani për vizatimet e këtij libri dhe për Format Printing Press për dizejnimin dhe shtypjen e këtij libri.

Dhe, sigurisht, si mund të harrojmë të gjithë miqtë tanë të vegjël në të gjithë botën, që na kanë frymëzuar për të shkruar këtë libër.

Pasi ta keni lexuar këtë libër ne do t'ju luteshim të na jepnit mendimin tuaj për të. Në faqen e fundit të librit është një formular, të cilin ju mund ta plotësoni me një të rritur dhe të na e dërgoni. Ne duam të dëgjojmë se ç'mendoni. Mendimi juaj do të na ndihmojë ta bëjmë librin edhe më të mirë.



Lena Karlson
Kryetare e Grupit Global Task
mbi Dhunën ndaj Fëmijëve

Shënime për prindërit, mësuesit, kujdestarët dhe të rriturit e tjerë të cilët punojnë me fëmijë të vegjël

Ky libër është shkruar posaçërisht për vajza dhe djem të moshës 7 deri 12 vjeç. Edhe fëmijë të tjerë, adoleshentë dhe më të rritur mund të përfitojnë nga ky libër.

Me këtë libër s'është menduar që fëmijët do të pajisen me shprehje të atilla që shmangin abuzimet në kurriz të tyre. Por ai mund t'i ndihmojë ata të mësojnë rreth llojet e dhunës me të cilat përballen fëmijët në mbarë botën dhe u jep disa ide se si të mund të mbrohen nga dhuna.

Tema është shumë e ndjeshme. Puna me fëmijë më të vegjël duhet bërë me shumë kujdes. Është e rëndësishme që shpjegimet dhe mesazhet që do t'u jepen fëmijëve rreth dhunës të jenë në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tyre. Të bisedosh për dhunën me një fëmijë 7-të vjeçar

është diçka krejt e ndryshme nga diskutimi për dhunën me një 14-të vjeçar.






Fëmija ta lexojë vetë të gjithë kapitullin apo librin në varësi të kohës që ka në dispozicion dhe të moshës së vet. Kur ta këtë mbaruar, ju mund të filloni të diskutoni me të disa nga çështjet që ngrihen aty.

Disa nga temat mund të jenë të vështira për t'u kuptuar, prandaj është e rëndësishme që ju, si më i rritur, t'i qëndroni pranë për t'ia shpjeguar ato.

Në libër ndeshen çështje të hapura, të cilat mund ta ndihmojnë fëmijën ta hetojë edhe më thellë temën.

Të rriturit që do t'i ndihmojnë fëmijët ta lexojnë dhe ta kuptojnë këtë libër mund të duan të bëjnë disa pyetje, por është e rëndësishme që askush të mos shtrëngohet të flasë nëse nuk do.



URRA!
PO FILLLOJME





Unë kam të drejtë të rroj
pa asnjë lloj dhune ...
... Unë ndiej përgjegjësi
që të mos i lëndo
të tjerët



Tungjatjeta vajza dhe djem të gjithë botës. Ky libër është për ju. Edhe ti që je i rritur mund ta lexosh këtë libër. Ai flet për dhunën ndaj fëmijëve.

Dhunë kemi kur dikush të lëndon me qëllim dhe të bën të ndihesh keq. Po qe se lëndohesh ose njeh dikë të cilin e kanë lënduar, ky libër vjen në ndihmë.

Lexoje këtë libër me prindërit, me mësuesin apo një të rritur të cilit i beson. Ata mund të të ndihmojnë ta kuptosh më mirë lëndën dhe të mësosh fjalët e reja.



Ja se ç' do të mësosh nga ky libër:

DISA GJËRË QË DUHEN

DITUR

- Ç' është dhuna ndaj fëmijëve?
- Ç' thotë Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve?
- Ç' thuhet në Studimin e OKB-së për Dhunën ndaj Fëmijëve?
- Çfarë zbulohet në Studimin e OKB-së?

IDETË QË KANË FËMIJËT

Këtu mund të mësoni se ç' ide kanë fëmijët për t' i dhënë fund dhunës ndaj vajzave dhe djemve.

AKSIONET E FËMIJËVE

Këtu ju mund të lexoni se çfarë po bëjnë fëmijët e tjerë për të ndalur dhunën ndaj fëmijëve.

ÇFARË DUHET TË BËNI QË TË MOS JU LËNDOJNË

Këtu ju mund të zbuloni disa nga mënyrat për të ruajtur veten dhe fëmijët e tjerë.





Ç' është Dhuna ndaj Fëmijëve?

Dhunë kemi kur dikush të lëndon me qëllim dhe të bën të ndihesh keq. Kjo do të thotë të lëndosh trupin apo ndjenjat e një tjetri. Edhe kur dikush thotë me fjalë se do të të lëndojë, edhe kjo është dhunë. Dhunë kemi edhe kur njerëzit e lëndojnë veten me para-

mendim. Ka disa lloje dhune me të cilat përballen vajzat dhe djemtë në mbarë botën. Ndonjëherë vajzat dhe djemtë i rrahin, atyre u bërtasin, ose i rbyllin brenda. Herë – herë vajzat dhe djemtë i prekin në një mënyrë që atyre s' u pëlqen, që i bën të ndihen keq dhe i vë në siklet. Duke vazhduar leximin e librit, ju do të mësoni më shumë për këtë.

Ju duhet ta dini se ka shumë të rritur që ju duan dhe nuk duan t' ju bëjnë të ndiheni keq.



E MIRË APO JO E MIRË?

A mund të na thoni se cilat nga veprimet e mëposhtme janë dhunë ndaj fëmijëve? Nëse mendon që veprimi është i mirë, vendos një ✓, nëse mendon që veprimi nuk është i mirë vendos një X mbi fytyrë.



Babai po uth vajzën e tij.



Një xhaxha po i tregon nipit të tij fotografi me gra të zhveshura.



Nëna rreh vajzën e saj sepse ka derdhur qumështin mbi qilim.



Komshiu juaj i bërtet gjithë kohës vajzës që punon në shtëpinë e tij.



Babai po rreh të birin për ta ndëshkuar.



Një djalë të vogël e kanë futur në burg dhe policia po e rreh sepse ai vodhi fruta në treg.



Një djalë i madh po shtyn një djalë të vogël për t' i zënë vendin në mensën e shkollës.



Babai po i lexon një libër djalit të tij.



Një mësues i thotë nxënësit 'budalla' ngaqë ai ka harruar detyrat e shtëpisë.



Një komshi po të prek në një mënyrë që të bën të ndihesh keq dhe në siklet.


A të shkon ndërmend ndonjë shembull tjetër dhunë ndaj fëmijëve?





Ç' janë Kombet e Bashkuara?

Udhëheqësit e vendeve tona kanë premtuar që fëmijët të mos i lëndojë kush e të rriten të shëndetshëm. Këta udhëheqës janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara (OKB-së). OKB-ja është një organizatë (një lloj klubi) ku udhëheqësit nga pothuaj të gjitha vendet e botës takohen dhe flasin për mënyrën se si ta bëjnë botën një vend të sigurt. Ata duan që edhe jeta e të gjithë të rriturve dhe fëmijëve të bëhet më e mirë.



Ç' është Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve?

Udhëheqësit e botës besojnë se fëmijët janë të veçantë dhe se ata zënë një vend të veçantë në këtë botë. Prandaj ata u takuan më 1989 në ndërtesën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork dhe shkruan një dokument që u quajt Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC). Ky dokument thotë se fëmijët kanë të drejta të rëndësishme.



A i njihni ju të drejtat tuaja?

Të drejtat tuaja janë gjërat që ju duhet të keni dhe gjërat që njerëzit që përgjigjen për ju duhet të bëjnë për ju. Ata të gjithë duhet të punojnë që t'ju bëjnë të luntur, t'ju mbrojnë, t'ju arsimojnë dhe t'ju flasin për gjëra që janë të rëndësishme për ju.

Ju i keni këto të drejta, kushdo qofshi ju, kushdo qofshin prindërit tuaj, e çfarëdo ngjyre qoftë lëkura juaj, çfarëdo



Ju keni të drejta,
por ju keni edhe
përgjegjësi.

feje t'i përkisni, çfarëdo gjuhe që të flisni, paçi apo jo një aftësi të kufizuar, qofshi të pasur apo të varfër, vajzë apo djalë.

Pothuajse të gjitha vendet e botës e kanë nënshkruar këtë dokument. Kjo do të thotë se ata kanë dhënë fjalën se do të bëjnë gjithçka që mundën që fëmijët të gëzojnë të drejtat e tyre.



Në një vend të UNCRC (të rriturit e quajnë atë Neni 19) thuhet se kurrkush nuk ka të drejtë t'ju lëndojë. Prindërit apo të tjerë që gjykojnë që kujdesen për ju, nuk kanë të drejtë t'ju lëndojnë apo të sillen keq me ju.

Qeveria juaj, prindërit dhe të rritur të tjerë duhet të bëjnë çmos që mbi ju të mos ushtrohet dhunë. Juve duhet t'ju jepet mundësia të kërkonit ndihmë kur lëndoheni apo kur dikush sillet keq me ju.


A e dinit se?

Më 1919, Eglantina Xheb, themeluesja e Save the Children, ka thënë se fëmijët duhet të gëzojnë të drejta të veçanta. Kjo ka ndodhur 87 vjet më parë. Save the Children ende punon për të drejtat e fëmijëve, që t'i bëjë jetët e fëmijëve më të mira.



Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) i ka kërkuar Prof. Paulo Pinheiro të mësojë se përse kaq shumë fëmijë në të gjithë botën lëndohen dhe trajtohen keq. Ky quhet Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve.



Një shoqatë joqeveritare është një grup njerëzish të cilët punojnë që ta bëjnë jetën e njerëzve (të fëmijëve dhe të rriturve) më të mirë. Ata nuk punojnë për qeverinë.

Ndonjëherë ata punojnë edhe për t'u kujdesur për pyjet, detet dhe liqenet.



Studimi drejtoi vëmendjen në vende ku ushtrohet dhunë ndaj fëmijëve: në shtëpi, në shkolla, në vende ku fëmijët jetojnë pa prindërit e tyre, në vendet ku ata punojnë dhe në lagjet e tyre. Vëmendja u drejtua edhe ndaj dhunës mbi fëmijët që i kap policia.

Studimi u interesua dhe për idetë mbi si të ndalet dhuna ndaj fëmijëve dhe si të rriturit, fëmijët, qeveritë dhe shoqatat joqeveritare mund t'i ndihmojnë fëmijët të cilët përballen me dhunën çdo ditë.

Shumë vajza dhe fëmijë nga e tërë bota kanë marrë pjesë në këtë Studim. Fëmijët kanë folur për të gjitha llojet e dhunës që ata njohin.

Vajzat dhe djemtë shpjeguan se është e rëndësishme që gjërat t' i bëjnë bashkë me të rriturit për të shmangur dhe ndaluar dhunën ndaj fëmijëve.

Të mos flitet për
ne kur s' jemi
të pranishëm



Këtë e tha një grup fëmijësh gjatë një takimi për Studimin e OKB-së për Fëmijët në Amerikën e Veriut. Mbledhja u zhvillua në Toronto, Kanada, më 3 qershor, 2006¹.

¹ Konsultim rajonal për Studimin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve në Amerikën e Veriut.



Nëse doni të mësoni më shumë rreth Studimit, mund të lexoni ose shikoni faqet e internetit, librat apo filmin e mëposhtëm:


www.violencestudy.org
www.rb.se/eng
www.crin.org
www.unicef.org

Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Dhunën ndaj Fëmijëve: e përshtatur për fëmijë dhe të rinj

E drejta e jonë për të qenë të mbrojtur nga Dhuna: Aktivitete për të Mësuar dhe për të ndërmarrë veprime për Fëmijët dhe të Rinjtë

Film: Veprime të Fëmijëve për t' i dhënë fund Dhunës ndaj Fëmijëve

Nëse s'keni internet, kontaktoni me Save the Children ose me zyrën e UNICEF në vendin tuaj dhe u kërkoni atyre këto libra dhe këtë film.





Çfarë zbulimi bëri Studimi?

Njerëzit që morën pjesë në Studim mësuan për llojet e shumta të Dhunës që fëmijët shohin dhe provojnë në kurriz të tyre çdo ditë.

Ndëshkimi Fizik

Nënat, baballarët, anëtarët e tjerë të familjes, mësuesit dhe të rritur të tjerë në vend që të kujdesen për fëmijët shpesh i ndëshkojnë ata duke i lënduar në trup apo duke fyer ndjenjat e tyre.

Unë zemërohem
vërtet kur dëgjoj
njerëz që më thonë
se 'Nëse nëna të
rreh, kjo të
ndihmon të
mritesh'.

Një djalë nga Rumaniaⁱⁱ



ⁱⁱ "Fëmijët i thonë NDAL! DHUNËS", Një broshurë, Save the Children Rumani, 2005

Për shembull,

- Rrahja, përplasja në tokë, rënia me shoqim, kapja për fyti, apo shkundja e një fëmije,
- Rrahja e tij me rrip, thupër apo lugë druri,
- Djegia e tij me shkrepëse, cigare, ose ujë të nxehtë,
- Mbyllja e tij në banjë ose në dhomë të errët,
- Shkulja e flokëve të tij.

A dini mënyrë tjetër
se si fëmijët ndëshkohen
fizikisht?



A mendoni se ndëshkimi
fizik është e vetmja
mënyrë për t'i treguar një
fëmije se ajo që ai apo ajo
bëri është e gabuar?



Disa të rritur mendojnë se ndëshkimi fizik i një fëmije është i drejtë pasi korrigjon (disiplinon) sjelljen e fëmijës.

POR S' ËSHTË ASHTU!!!!

Ta ndëshkosh fizikisht një fëmijë e bën atë të mendojë keq për veten e vet. Ata kujtojnë se "Unë jam një shkatarraq, një fëmijë i keq, prandaj mami më rreh; fajin e kam vetë".

Gjithashtu fëmija mund të trembet nga personi që e ndëshkon.

Po kështu fëmijët mund të mendojnë se dhe ata kanë të drejtë të rrahin dhe të lëndojnë të tjerët.



Abuzimi me fjalë

Abuzim me fjalë kemi kur përdoren fjalë për të fyer ndjenjat e fëmijëve apo për t' i kontrolluar ata.

Disa nga shembujt e abuzimit me fjalë janë:

- Klithja apo të bërtiturit,
- Të quajturit e fëmijës budalla, djalë i keq apo me fjalë të tjera të këqija,
- Kur i themi fëmijës se asnjë nuk e do,
- Kërcënimi i fëmijës,
- Mallkimi i fëmijës.

Këto gjëra të bëjnë të ndihesh keq dhe shumë i vogël, sidomos kur t' i thotë njeriu që ti do më shumë!

TREGO ME SHPREHJE TË FYTYRËS

Si e bën fytyrën kur dëgjon gjëra të ndryshme. Si do të ndiheshit ju nëse dikush do t'ju thoshte..

"Qenke i
zgjuar."



"Ti s'na hyn në
punë pasi paske
vetëm një dorë".



"Po ia tregove njeriu
të fshhtën do të të
mbyll në garazh e
s' do të dalësh më
që andej."




"Më pëlqeu se
si e ke vizatuar
atë pikturë!"

"Faleminderit
për ndihmën. Na
lehtësove shumë."



"Të gjitha
gjërat ti i bën
mbrapsht."





Moskujdesje

Kur prindërit, anëtarët e familjes, mësuesit dhe të mriturit e tjerë nuk tregojnë dashuri dhe kujdes për fëmijët, kjo njihet si moskujdesje ndaj tyre.



Disa shembuj moskujdesjeje janë:

- Të mos i flasësh një fëmije apo të mos u përgjigjesh pyetjeve të tij apo të saj,
- Ta lësh një fëmijë vetëm për një kohë të gjatë,
- Të mos i japësh bukë sa të ngopet.

A dini mënyra të tjera
të moskujdesjes
ndaj fëmijëve?



Ngacmimi seksual (Dhuna seksuale)

Ngacmimi seksual është një lloj prekjeje apo sjelljeje që i bën fëmijët të ndihen në siklet apo keq.

Disa shembuj ngacmimesh seksuale janë:

- Prekja e fëmijës në pjesë private të tij apo të saj. Këto janë ato pjesë të trupit që normalisht ne nuk ua tregojmë njerëzve të tjerë,

- Të detyrohet një fëmijë të prekë pjesët e tij apo të saj private apo të dikujt tjetër.
- Të bësh seks me një fëmijë,
- T' i tregosh një fëmije revista apo filma ku shfaqen figura me njerëz me pak rroba apo lakuriq,
- T' i tregosh një fëmije histori me 'fjalë të pista' apo shaka 'me fjalë të ndyra' .



Shpesh, njerëzit nuk duan të flasin për ngacmimin apo dhunën seksuale. Ato duan ta mbajnë të fshehur sepse u vjen turp. Shumica e ngacmimeve seksuale ndaj vajzave dhe djemve bëhet nga njerëz të cilët ata i njohin dhe të cilëve u besojnë.

Çfarë duhet të bësh nëse një mik të tregon se është ngacmuar seksualisht?

Pjesa e fundit e këtij libri tregon se si ta mbrosh veten!



GJEJ FJALËN E DUHUR

Përse nuk e provon të plotësosh vendet bosh këtu më poshtë? Në fund të çdo fjalie kemi disa shkronja të përziera. Përpiqu të formosh fjalë me to dhe të plotësosh fjalinë.

Për shembull,

Nuk është _____ juaj nëse dikush ju ngacmon seksualisht. (I F J A)

Kështu që përgjigja do të ishte,

Nuk është FAJI juaj nëse dikush ju ngacmon seksualisht.

1. Unë kam të drejtë të mos më dhunojë _____ (E R N J I)
2. Ju keni të _____ të thoni JO (R E Ë J D T)
3. _____ nuk është vonë të flasësh (R R U Ë K)
4. Flit me dikë të cilit i _____ (S N E O B)
5. _____ yt të takon vetëm ty (P I U R T)




Zënkë kacagjelas

Zënkë kacagjelas kemi kur një fëmijë apo grup fëmijësh kërcënon, poshtëron apo lëndon me dashje një fëmijë apo grup tjetër fëmijësh. Kacagjelat janë zakonisht fëmijë që përpiqen të frikësojnë fëmijë të tjerë që janë më të dobët apo më të vegjël se ata.

Shtembuj zënkash kacagjelas janë:

- Tallja me dikë,
- Përzënia e fëmijëve të tjerë nga fusha e lojës, nga mensa, apo stolat e ndenjjes,
- Shkelmimi, goditja me grusht apo kërcënimi i një fëmije apo grupi fëmijësh.



Ngacmimi mund të ndodhë në shkollë, rrugës për në shkollë, në fushën e lojës, jashtë në rrugë apo në vende të tjera.

A dini mënyrë tjetër se si i ngacmojnë vajzat dhe djemtë?



Dhunë ndaj fëmijëve që futen në telash me policinë dhe ligjin

Vajzat dhe djentë që nuk sillen mirë arrestohen nga policia dhe futen në burg ose mbyllën në qendra për fëmijë. Ndonjëherë policia i arreston fëmijët sepse ata janë të varfër, sepse vjedhin ndonjë frutë në treg ose shesin diçka në rrugë.

Këto janë disa shembuj se si vajzat dhe djentë lëndohen kur futen në telash me policinë:


- Në shumë vende fëmijët mbyllën në të njëjtën dhomë me të burgosur të rritur të cilët mund t' i lëndojnë ata fizikisht, mendërisht, ose seksualisht.
- Ndonjëherë ata rrihen nga policët apo rojet e burgut.
- Në disa vende të burgosurit e vegjël i futin në qeli të pista ku ka pak vend për të ndenjur.
- Shpesh atyre s' u jepet mundësia për të mësuar dhe për të luajtur.

Në vend që të futen në burg, fëmijët duhet të ndihmohen të kuptojnë se ajo që kanë bërë është e gabuar. Ata duhen ndihmuar të zgjidhin problemet e tyre. Policia dhe rojet e burgut duhet të bëjnë çmos që fëmijët të mos lëndohen. Ata duhet t' i njohin të drejtat e fëmijëve.



Idetë që kanë fëmijët

Si pjesë e Studimit të OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve, vajza dhe djem morën pjesë në takime që u zhvilluan kudo në botë. Në këto takime, vajza, djem dhe të rritur u pyetën se ç'mund të bëhet për të ndaluar dhunën kundër fëmijëve.



Idetë e fëmijëve për të ndaluar ndëshkimin fizik dhe ngacmimin me fjalë

- Të ndalet ndëshkimi fizik dhe ngacmimi me fjalë duke bërë ligje.
- Të mësohen të rriturit të rrisin fëmijët pa i lënduar ata.
- Të rriturit duhet t'i respektojnë fëmijët dhe të sillen mirë me ta.





FËMIJËT THANË GJITHASHTU SE
ATA DUAN TË PËRFSHIHEN NË
PROGRAMET E TË RRIATURVE DHE
TË NDËRMARRIN VEPRIME
KUNDËR DHUNËS

Idetë e fëmijëve për të ndaluar ngacmimin seksual

- Të rriturit që ngacmojnë seksualisht fëmijët duhen ndëshkuar.
- Duhet të kemi numra telefoni ku fëmijët të telefonojnë e të flasin pa ndrojtje për ngacmimet seksuale.
- Duhet të ketë vende ku fëmijët të mund të tregojnë për ngacmimet seksuale dhe të marrin ndihmë.
- Të mësohen fëmijët se si të ruhen që në moshë të njomë - ashtu siç thuhet në këtë libër.





Idetë e fëmijëve për të ndaluar Dhunën ndaj Fëmijëve në ato vende ku ajo ndodh më shpesh

Duke vazhduar leximin ju do të mësoni se çfarë thanë vajzat dhe djentë për të ndaluar dhunën në vende të tilla si:



SHTËPI

SHKOLLA

SHTËPI FËMIJËSH (Këto janë shtëpi për fëmijë që nuk jetojnë me nënën ose babanë e tyre, si burgje apo brefotroftë)

VENDE KU FËMIJËT PUNOJNË

NË LAGJE DHE NË RRUGË



Idetë e fëmijëve për të ndaluar Dhunën ndaj Fëmijëve në shtëpi dhe familje


- Nënat dhe baballarët duhet të na dëgjojnë dhe t' i marrin fjalët tona seriozisht.
- Të mësohen nënat dhe baballarët se si të na rrisin ne pa qenë të dhunshëm. Të na shpjegojnë kur bëjmë diçka të gabuar dhe të na mësojnë se si të sillemi më mirë.

Idetë e fëmijëve për të ndalur dhunën në shkolla

- Mësuesit duhet të japin mësim në atë mënyrë që fëmijët të mund të kuptojnë kollaj dhe që mësimi t' i kënaqë ata.
- Mësoni fëmijët të njohin të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.
- Të rriturit në shkolla duhet t' i ndihmojnë fëmijët të cilët kanë patur ngacmime.

Idetë e fëmijëve për të ndalur dhunën në Shtëpitë e Fëmijëve

- Mos u sillni me fëmijët që futen në telash me policinë si të ishin hajdutë.
- Mos i futni vajzat dhe djemtë në burg.
- Fëmijët që sillen keq duhen ndihmuar që të ndërrojnë sjelljen e tyre.




Idetë e fëmijëve për të ndalur dhunën në vendet ku ata punojnë

- Ndëshkoni njerëzit që i detyrojnë fëmijët të bëjnë punë shumë të rënda.
- I ndihmoni fëmijët që punojnë të ndjekin shkollën dhe të mësojnë.
- Punëdhënësit duhet të kujdesen për shëndetin e punëtorëve të vegjël dhe nuk duhet t' i lëndojnë ata.
- Fëmijët nuk duhet të punojnë në vende të rrezikshme.

Idetë e fëmijëve se si të ndalin dhunën në lagjet e tyre dhe në rrugë

- Të rriturit duhet t' i ndihmojnë fëmijët që të formojnë klube ose grupe. Kjo do t' i mbajë shumë fëmijë larg dhunës.
- Fëmijët kanë nevojë të mësojnë se ku mund të kërkojnë ndihmë kur ata shohin dhunë në lagjen e tyre ose në rrugë.



Aksionet e Fëmijëve

Kur ne shohim dhunë ne s' duhet të themi se s' jemi në gjendje të bëjmë kurrgjë. Ne mundemi dhe duhet të bëjmë diçka.

Një vajzë nga Maqedoniaⁱⁱⁱ.
Maqedonia është një vend në Evropën Juglindore



ⁱ Një video një minutëshe që e kanë bërë të rinjtë e projektit One Minute Jr, (Një Minutë e bërë nga Ju) të mbështetur nga UNICEF, Fondacioni Evropian i Kulturës dhe Instituti Sandberg



Ne do t' ju tregojmë se çfarë po bëjnë vajzat dhe djemtë në të gjithë botën për të ndalur dhunën kundër tyre. Shumë vajza dhe djem në anë të ndryshme të botës kanë ngritur grupe për të ndalur dhunën.

Një grup vajzash dhe djemsh më të rritur në Hong Kong po bisedojnë me fëmijë dhe të rritur mbi dhunën në shtëpi.

Në Jemen, fëmijë dhe të rritur, u takuan me policinë. Ato i thanë policisë se fëmijët nuk duhen mbyllur në qelitë e policisë.

Vajza dhe djem në Nikaragua dhe në Bangladesh kanë bërë shfaqje televizive për t' i njohur njerëzit me ndëshkimin fizik dhe ngacmimin seksual dhe se si këto i lëndojnë fëmijët.

A e keni marrë vesh se vajzat dhe djemtë në Rumani kanë kremtuar një ditë të veçantë, atë të 'Ditës kundër Dhunës' më 5 qershor të çdo viti? A s' është kjo një gjë e mirë?

Bobo! Harruam t' ju themi se ku ndodhen këto vende në atlasin tuaj. Ju mund të pyetni një të rritur që t' ju ndihmojë.



HISTORIA E ANËS

Tani ne do t'ju tregojmë për një ngjarje të vërtetë, se si një grup fëmijësh qenë të zotë ta ndihmojnë një shoqe, e cila u ngacmua seksualisht nga një mësues. Kjo ka ndodhur në Zambia. A e dini ku është Zambia? Zambia është një vend në Afrikën e Jugut.



Takoj



Ne i kemi ndryshuar emrat dhe kemi shkruar dialogët. Por ngjarja është e vërtetë.

33

Përse s'po vjen më në klubin e shkollës, Ana?

Kisala, mua s'më pëlqen më të shkoj atje.



Ti duhet të vish. Ne do të flasim për pjesëmarrjen e fëmijëve këtë javë. Kjo do të thotë se kur ne flasim për gjëra të rëndësishme në jetën tonë, të rriturit duhet të na dëgjojnë dhe t'i marrin fjalët tona seriozisht...



Ti duhet të vish.



Ti rri larg nga shokët. Në kemi nevojë për ndihmën tënde. Ti s'po luan më me ne. Po s'erdhe në klubin e shkollës unë s'do të të flas më me gjë.



Kisala flet për Anën me shoqet e tjera në klubin e shkollës.

Jam e shqetësuar vërtet për Anën. Këto ditë ajo duket e dëshpëruar dhe rri e vetmuar.

Vë bast se ajo ka rënë në dashuri.



Shkojmë të flasim me të.

Unë vë bast që jo.



Çfarë ke Ana? Ti s'po vjen më në klubin e shkollës.

Dhe s'ke më qejf të flasësh apo të luash me ne. Mos të ka rrobhur gjë?



Mos ke rënë në dashuri?

Jo, Thandi. Unë kujtova se Kisala s'do të më fliste më me gojë.

Unë jam mikesha juaj më emirë. Si s'da të flas me ju?

35



Ana u flet për mësuesin e tyre. Banda, që u mëson atyre të drejtat e fëmijëve.

Një ditë ai më thirri në dhomën e tij dhe më kërkoi ta ndihmoja për t'i pastuar raftin me libra. Në fillim ai më kapi në supë dhe pastaj m'i futi duart poshtë bluzës. Unë u lutova shumë dhe më echi mbt.



Një ditë tjetër, pas mësimit, ai më gjeti vetëm në korridorin e shkollës. Më shtyu në qoshe dhe më preku prapë me duar poshtë rrobave të mia.



Në rregull. E kuptojmë që ai të ka ngacmuar. Ne do të të ndihmojmë.





S'është faji yt. Nëna më thotë se nëse dikush të ngacmon me duar e të ve në siklet, kynuk është faji yt...



.....Në dhjet t'ia tregojnë këtë dikujt që i besojnë, që të na ndihmojnë.

Pasi i dëgjuan fjalët e Anës, vajzat e tjera të shkollës treguan dhe ato se si z. Banda i kishte prekur në mënyrë të poshtër.

Kur ai më prek me dorë unë e ndiej veten shumë keq.

Ai vazhdon të më prekë ashtu edhe kur unë i them JO.

Prekja e tij më fut kupën dhe më frikëson.



Vajzat shkojnë te drejtori dhe i tregojnë atij historitë e tyre. Drejtori i dëgjon. Ai mbetet i shtangur.



Mësuesin e thërrasin në zyrën e tij.

Z. Banda hiqet sikur s' di gjë.



S' e kam bërë unë. Këto vajza gënjejnë. Këto janë histori të sajura.



Ne u besojmë miqve tanë dhe jo juve. Ne s' du të lejojmë që ju të lëndoni herë tjetër shoqët tonë.

Ne s' të kemi më frikë.



Ke të drejtë Levi. Ne ju besojmë, fëmijë.



Zotin Banda e mori me vete policia.



Faleminderit vajza që e ngritët zërin tuaj. Është e rëndësishme të na tregoni kur dikush ju lëndon, që dhe ne t'ju mbrojmë.



HISTORIA E PRITIT

Ja dhe një ndodhi tjetër se si një grup djemsh krijojnë lojëra dhe këngë për t' i dhënë fund martesave në moshë të vogël të vajzave të lagjes së tyre në Indi^{iv}.

Takimi



Priti do
martohet!!

Sa mirë. Kush çenka ky djalë i pafat?

Raju, mos u trego vajzë e e keqe. Mamaja më tha se Priti është vetëm 12 vjeç, shumë e vogël për t' u martuar.

Unë kam kujtuar se në martesë bën qejf. Atje hahen gjëra të mira, njerëzit vishen bukur. Ajo do të veshë rroba të reja dhe shumë gurë të çmuar...

....Hej, edhe unë mund të gjej ca rroba të reja.



^{iv} Ky është një grup fëmijësh në Gorakhpur, Indi i mbështetur nga MASVAW.

Aedini sesi dt' i shkojë filli
asaj?



Ajo do të bëjë një bebe të
bukur dhe bebja do të më
thërrasë mua xhaxhi Raju.



Raju, ti je 12 vjeç, pse
s' martdesh dhe ti?.....


..... Ti mund të vishesh
bukur në dasmë dhe bebja
do të thërrasë Baba.



Ehu, unë jam shumë i
vogël për t' u kujdesur për
gruan dhe fëmijën. Unë dua
të studioj. Mua më kanë mbetur
dhe shumë vjet
për të mbanuar
shkollën...



..... Unë dua të luaj
në ara, në lumë,
të ngjitem në pemë.
Të martuarit s' bëjnë
gjëra të tilla, apo jo?



Ro Priti, a s' është dhe ajo e re? Ç' kujton
ti se ajo nuk do ta mbarojë shkollën?
Ti kujton se ajo nuk
do të luajë me
shoqet e saj?



Jo more,
as që më
shkon
mendja
ty.

Harruat se ç' i
ndodhi Semës kur
u martua?

U zhduk fare.
Ajo s' luan më me ne.

S'e lënë më të luajë me ne.
Ajo duhet të gatujë, të
pastrojë, të ndihmojë
familjen e burrit në punët
e shtëpisë, të mbushë
ujë në lumë dhe
të bëjë shumë
prë të tjera.

Atë s'e lënë as të
shkojë në shkollë dhe
e rrahin po ta shohin
duke folur me djem.

Rëses' i
thua
shokut tënd
të shtrëngjtë
Raju se
buri i saj
dhe
familja e tij
e rrahin?

Familja e Semës s' kishte prirë
për t' ia dhënë familjes së burrit
të saj, prandaj ata e
rrahin shpesh.

Prika është një shumë parash apo dhurata
që familja e ruses i jep familjes së
dhëndrit. Po të marrë vesh policia se
familja e dhëndrit ka marrë para nga
familja e Semës, burrin e
saj e çojnë në burg.

Çfarë është prika?

Atëherë ne duhet
ta prishim këtë
martesë.

Posi?

Unë njoh një grup në Gorakhpur që organizon shfaqje, këngë dhe lojëra për t'i njohur banorët e lagjes me martesat në moshë të njomë, me prikat dhe format e tjera të dhunës ndaj vajzave. Hera-herës u thonë vajzave dhe banorëve të lagjes të bashkohen me ta.



Edhe ne të veprojmë kështu!



Të nesërmen, Mina, Rohit dhe Raju u takuan me djemtë në Gorakhpur. Djemtë u treguan të gatshëm t'i ndihmojnë. Ata luajtën dhe kënduan para familjes së Pritës. Edhe Mina, Rohit dhe Raju morën pjesë në këtë program.



41

Në këtë mënyrë, ata u thonë njerëzve se nuk është e drejtë që fëmijët të martohen të vegjël.



Këto vajza dhe djem kanë të drejtë. Unë them se duhet ta dëgjojmë zërin e tyre dhe ta ndalim këtë martesë. Priti duhet të mbarojë njëherë shkollën dhe të bëhet për martesë.



Mendja dhe trupi i saj nuk janë akoma gati për martesë.

Prindërit dhe pjesëtarët e tjerë të familjes së Pritit u janë mirënjohës grupit të djemve dhe shoqëve të Pritit që e ndaluan këtë martesë.

Priti, ti mund të kthësh tani në shkollë. Ne s' duhet të flasim më për martesën tënde. Deri sa ti të bëresh 18 vjeç.





42

Çfarë duhet të bësh që ta ruash veten

Kjo pjesë e Librit do t'ju ndihmojë
të mbroshi veten dhe fëmijët e tjerë
nga dhuna.



Gjëra që s' duhen harruar

Nëse dikush të lëndon, KY NUK
ESHTË FAJI YT.

TI JE PERSON I VEÇANTË.

TI GËZON TË DREJTA.

Ti gëzon të drejtën për të patur
shëndet të mirë, për studiuar,
për të luajtur dhe për t'u mbrojtur
nga dhuna.



Çfarë mund të bësh për t'u mbrojtur vetë dhe për të mbrojtur fëmijët e tjerë nga dhuna

Thua "JO"

Ti ke të drejtë t' i thuash "JO" kujtdo që përpiqet të të prekë në atë mënyrë që të bën të ndihesh keq apo i frikësuar.




Disa gjëra që s' duhet të mbahen kurrë të fshehta

Ka disa gjëra që ju nuk duhet t' i mbani kurrë të fshehta, edhe sikur të keni dhënë fjalën se nuk do t' ia tregoni kujt. Asnjë kacagjel nuk duhet të të kërkojë të mbash të fshehtë një zënkë kacagjelas.

Shpesh, njerëz që bëjnë të keqja në kurriz të fëmijëve u thonë atyre që të mos u tregojnë të tjerëve se çfarë u ka ndodhur. Ata e dinë se kanë bërë gabim dhe kanë frikë se do të ndëshkohen.

Përçafimet, puthjet janë të mira, sidomos kur na i bëjnë njerëzit që na duan. Por, asnjëri s' duhet të na kërkojë të mbajmë të fshehur një përçafim, puthje apo një prekje. Të rriturit mund të thonë se ky 'është një sekret i vogël'. Nëse dikush e thotë këtë, edhe sikur ta njihni këtë person, duhet të flisni me një të rritur, të cilit i besoni.





Trupi të takon vetëm ty

Mëso se si quhen pjesët e trupit tënd dhe mëso dallimin mes 'prekjes së mirë' dhe 'ngacnimit'. Askush s' duhet të prekë në mënyrë të atillë apo në vende ku t' i ndihesh keq. Edhe ti nuk duhet t' i prekësh të tjerët në atë mënyrë që ata ta ndiejnë veten keq apo në siklet. Flit me të rritur të cilëve u beson, sa herë që dyshon për prekjen apo sjelljen e dikujt tjetër.



Klithrja

Është e drejtë të këlthasësh dhe të gërthasësh nëse dikush të lëndon. S' duhet të kesh druajtje të këlthasësh apo të kërkosh ndihmë kur je në hall.

Mos prano dhurata

Mos prano ëmbëlsira, para apo dhurata nga askush pa i thënë më parë mamasë tënde, babait apo personit që kujdeset për ty. Nuk është gabim të pranosh dhurata nga miqtë dhe njerëzit e familjes. Por disa të rritur, që ju i njohni dhe u besoni, mund t' ju japin dhurata dhe para për t' ju joshur që të bëni diçka të gabuar.

Fol me dikë

Nëse të ndëshkojnë fizikisht, me fjalë, nëse të ngacmojnë seksualisht apo kërkojnë të zihen me ty, fol me një mik, një mësues, me prindërit e tu, me një të rritur të cilit ti i beson. Kjo mund të mos jetë gjë e lehtë. Po qe se nuk do të flasësh, shkruaji ato që do në letër dhe shpjegoja nënës tënde ose babait se çfarë ndjen.

Vrapo apo largohu menjëherë

Nëse një i huaj apo dikush që ti e njeh përploqet të të bëjë keq, largohu menjëherë dhe vrapo. Kërko ndihmë. Vrapo drejt vendeve ku ka shumë njerëz.



Nëse e ke të vështirë të flasësh me mamën apo babin për ngacmimin, atëherë fol me dikë të cilit i beson.

Nëse ai që të ngacmon është mami, babi apo mësuesi, flit me dikë të cilit i beson, me gjyshin apo gjyshen, tezen, xhajën, kushëririn apo një komshi.


Mëso për dhunën ndaj fëmijëve

Mëso gjëra të tjera për dhunën ndaj fëmijëve. Ti mund të kërkosh në internet, të shkosh në bibliotekë ose të flasësh me mësues, miq apo të rritur të tjerë të cilëve u beson.



Telefona një linjë në ndihmë të fëmijëve

Një linjë telefoni në ndihmë të fëmijëve është një numër telefoni falas të cilit mund t'i telefononi për të folur me dikë mbi problemet që keni. Ju mund të flisni për dhunën me të cilën përballeni ju apo shoku ose shoqja juaj. Pyetni të rriturit të cilëve u besoni për të gjetur numrin e linjës telefonike në ndihmë të fëmijëve në zonën ku banoni.



Mbaj shënim numrat e urgjencës

Mbaj gjithë kohës me vete numrat e telefonit të urgjencës, si numrat e telefonit të mamit dhe babit, të njerëzve të tjerë që kujdesen për ty, të policisë, doktorit, të mikut të besuar, të një komshiu apo numrin e mësuesit.

Telefoni një linjë në ndihmë të fëmijëve

Njofto policinë.

Mos e mbaj të fshehtë.

Kurrë s'është vonë t'ia tregosh dikujt.

Tani që keni mësuar për dhunën, ju mund të ndihmoni veten dhe fëmijët e tjerë për ta ruajtur veten. Flisni me fëmijë të tjerë për Studimin e OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve dhe për gjërat e tjera që keni mësuar në këtë libër.

Pesë gjëra që unë i kam mësuar nga ky libër janë:

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5


Mos u tremb nga gjërat që thotë libri. Në botë ka njerëz të ndryshëm. Ka dhe të tillë që mund të lëndojnë. Por shumica e tyre janë njerëz të mirë, të dashur dhe që duan të kujdesen për ty.







Mos harro t' u tregosh të rriturve kur dikush të lëndon.

Mos harro se s' është faji yt, kur dikush të lëndon.

**MOS HARRO, SE PËR
ÇFARËDO ARSYE,
DHUNA ËSHTË E
PADREJTË!**



Na thuj se ç'mendon për këtë libër

		Shkëlqyeshëm 	Mirë 	Jo dhe aq mirë 	Keq 	Keni gjë tjetër për të thënë?
N ë përgjithësi 						
Gjuha/ Fjalët e përdorura 						
Vizatimet, Pikturat 						
Ngjyra 						



Çfarë më pëlqeu më shumë në këtë libër?

.....

Çfarë nuk më pëlqeu te ky libër?

.....

Si mund ta përmirësojmë akoma këtë libër?

.....

Ju mund t' i dërgoni me postë në këtë adresë:

Save the Children Sweden

Regional Office for South and Central Asia

GPO 5850, Lalitpur, Kathmandu, Nepal

Tel: +977-1-5531928/9

Fax: +977-1-5527266

Ose, nëse keni internet, mund të na dërgoni një e-mail për të na thënë se ç'mendoni për këtë libër.

I shkruani neha@savethechildren.org.np,

nehab@sca.savethechildren.se dhe lena.karlsson@rb.se

Ngjyrose vizatimin





Save the Children